



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 21558 / Prot.
11

Tiranë, më 2.12.2020

URDHËR

Nr. 277 /, Datë 2.12.2020
11 PËR

NJË NDRYSHIM NË URDHËR NR. 277, datë 17.11.2020 “PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËRZGJEDHËSE TË KANDIDATIT PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË NJËSISË MENAXHIMIT TË PROGRAMIT (PMU) “Italian-Albanian SME-s, Development Programme – PRODAPS”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ndryshuar, nenit 7 të ligjit nr. 9000, datë 31.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” si dhe të nenit 113 të ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar ;

Me qëllim, kryerjen e procedurës përzgjedhëse të kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të Programit (PMU) “**Italian-Albanian SME-s, Development Programme – PRODAPS**”, në një periudhë kohe ku situata pandemike për shkak të Covid – 19 të mundësojë një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe cilësore të kandidatëve të interesuar,

URDHËROJ:

1. Pika 5 e Urdhër nr. 277, datë 17.11.2020 “Për fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatit për pozicionin e drejtorit të Njesisë Menaxhimit të Programit (PMU) “Italian-

Albanian SME-s, Development Programme – PRODAPS” (Urdhër nr. 277), ndryshon dhe bëhet:

“ 5. Afati i dorëzimit të aplikimit dhe dokumenteve të përcaktuara në Aneksin 1 të këtij Urdhëri, në zyrën e Protokollit të MFE, do të përcaktohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet njoftimit që do të publikohet në faqen web të MFE. Aplikimet e depozituara nga aplikantët deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij urdhëri, janë të vlefshme edhe për periudhën në vijim, dhe do të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit në afatin e ri që do të njoftohet.”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhëri. ✓

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

